

TË DHËNAT TEKNIKE

Komponent A

Pamja: Pluhur
Paketimi: Kovë 5 kg
Ngjyra: Gri
Konsumi: 1,20-1,40 kg/m ² (dy duar) 1,80-2,00 kg/m ² (tre)
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit
pH i përzjerjes: >12
Masa vëllimore: 1.3 – 1.4 gr/cm ³
Trashësia për shtresë: 2 mm (për dorë)
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Kokrrizimi: 0.4mm
Ngjitja në beton (28 ditë): ≥0.5 N/mm ²
Përshkueshmëria ndaj ujit: 0.15 kg /m ² . h 0.5
Forca ngjitëse pas trajtimit termik: ≥0.8 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1

Komponent B

Pamja: Lëng
Paketimi: Kovë Lëng 5 Kg
Ngjyra: E bardhë
Magazinimi: 24 muaj
Masa Vëllimore: 1.1 gr/cm ³



dekoll®

PREMIX PER L'EDILIZIA

DEKOPROOF ADVANCED



PËRSHKRIMI

Membranë hidroizoluese dy-komponentëshe me bazë çimento dhe polimer fleksibël, e projektuar për hidroizolim të jashtëm dhe të brendshëm. E përshtatshme për bazamente që i nënshtrohen presioneve pozitive dhe negative të ujit, duke ofruar një shtresë elastike dhe të papërshkueshme. I përshtatshëm për hidroizolim të tualetëve, duarve, ballkonëve, bodrumëve, pusëve, rezervuarëve uji dhe trajtimi të ujerave të pijshëm.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

- Hidroizolim i fuqishëm dhe fleksibël
- Nuk kërkon rrjetë përforcuese me fibra qelqi
- Aplikim i lehtë me furçë ose rull në sipërfaqe vertikale dhe horizontale
- Rezistencë e lartë ndaj lagështirës dhe kimikateve
- I përshtatshëm për mjedise me ujë të pijshëm
- Mbrojtje afatgjatë ndaj çarjeve dhe deformimeve. Aplikohet me furçe ose rull si në sipërfaqe vertikale ashtu dhe ato horizontale. Nuk është e nevojshme vendosja e rrjetës përforcuese me fibra qelqi.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një stazhionim të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suportëve duhet të pastrohen paraprakisht për aplikimin e produktit në mënyrë mekanike. Në rastin kur suporti është pllakë, duhet bërë zmerilimi i tyre kur behet hidroizolimi i nyjeve vertikale dhe horizontale, paraprakisht duhet të aplikohet Dekoband.



MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES DHE APLIKIMI

Hidhni komponentin A pluhur 5 kg në komponentin e lëngshëm (5 kg). Përzieni me një përzierës mekanik derisa të arrihet një masë homogjene, pa kokrriza dhe pa filluska ajri. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë. Aplikoni produktin në dy ose tre shtresa shtresa me furçë, rull duke e aplikuar rreth 2 mm për çdo dorë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 6-24 ore nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. E njëjta procedure të ndiqet dhe për doren e tretë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperatura nga +5°C deri +35°C.

